



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501840/2

Tiranë, __. __. 2015

Lënda: Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për anulimin e sasisë së kWh shtesë të energjisë elektrike, si pasojë e një gabimi në faturën e muajit prill 2015, ndaj shtetasit Sh. Ç., banues në Lagjen 15, Rr. "Bashtova", Durrës.

Drejtuar: OPERATORIT TE SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE
Drejtorisë Rajonale

D U R R Ë S

Për dijeni: OPERATORIT TE SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE
Administratorit, Z. Adrian ÇELA,

T I R A N Ë

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të konsumatorit, ka nisur shqyrtimin e ankesës së shtetasit Sh. Ç.. (me nr. kontrate DU0A030009033139), i cili ankohet ndaj "OSHEE" sh.a., drejtoria rajonale Durrës, lidhur me një sasi shtesë të energjisë elektrike vendosur gabimisht në faturën e muajit prill 2015.

Konkretisht, ankuesi pretendon se në faturën tatimore të muajit mars 2015 rezulton me një sasi energjie të matur (**leximi aktual 36376** - leximi i mëparshëm 35902) prej 474 kWh. Ndërsa në faturën tatimore të muajit prill 2015 rezulton me një sasi energjie të matur (**leximi aktual 36951** - leximi i mëparshëm 34604), prej 2347 kWh, kur në fakt duhet të ishte në sasinë 575 kWh energji elektrike e konsumuar realisht. Sipas tij, megjithëse ka kërkuar korigjimin e këtij gabimi, pranë zyrave të kujdesit ndaj klientit, ende nuk ka asnjë përgjigje zyrtare.

Institucioni i Avokati të Popullit duke e vlerësuar të drejtë dhe të bazuar në ligj këtë ankesë, kërkon të sjellë në vëmendjen tuaj se këto veprime nga ana juaj vijnë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi duke dëmtonuar jo vetëm interesat e ligjshme të këtij abonenti si konsumator i kompanisë tuaj, por edhe duke rënduar buxhetin e tij familjar në mënyrë të padrejtë.

Konkretisht, në nenin 40 të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorit", i ndryshuar, parashikohet se:

1. *Shitja e energjisë llogaritet në bazë të konsumit real dhe vlerësohet nëpërmjet aparateve matëse.*

...
3. *Faturat e paraqitura konsumatorit duhet t'i japin atij mundësinë për të verifikuar me përpikëri llogaritjen e shitjes ose shërbimit të siguruar për një periudhë të caktuar.*

Ndërsa, në pikën 7.4 të Kodit të Matjes, është parashikuar se: "Tregimi i matësit do të lexohet dhe do të regjistrohet për çdo muaj për të realizuar balancën e Energjisë Elektrike"

Nga këqyrja e dy faturave tatimore, konstatohet një gabim në faturën e muajit prill 2015, në rubrikën energji e matur leximi i mëparshëm duhet të ishte 36376 kWh dhe jo 34604 kWh.

Mosveprimet tuaja për korrigjimin dhe anulimin e kësaj sasive, kanë vijnë në kundërshtim me neni 12 të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike, ku parashikohet:

12.1 Klienti ka të drejtë të paraqesë një ankesë pranë Furnizuesit për çdo veprim apo mosveprim të furnizuesit që lidhet me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë, me shkrim, me gojë, me telefon ose në rrugë elektronike.

12.5 Në rast se pas verifikimeve të furnizuesit, rezulton se konsumatori është mbifaturuar, atëherë furnizuesi:

Anulon faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrigjuar

...

12.6 Për faturat e konstatuara nga klienti që rezultojnë me faturime dukshëm më të mëdha se faturimet mujore të tij (të krahasueshme ose më shumë se trefishi i faturimit mesatar mujor), furnizuesi pezullon faturën dhe realizon me procedurë të përsheptuar verifikimin, anulimin dhe nxjerrjen e faturës së korrigjuar brenda 10 ditëve.

Në bazë të dispozitave ligjore të cituara më lart, nga ana juaj nuk janë marrë masat ligjore brenda afateve kohore 10 ditore për verifikimin e kësaj ankese dhe anulimin e kësaj fature.

Institucioni i Avokatit të Popullit nisur nga qëllimi i mirë për përmirësimin e punës në funksion të mbrojtjes së interesave të ligjshme të konsumatorëve si dhe zgjidhjen ligjore të këtij problemi, e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim për të kontribuar së bashku për vënien në vend të të drejtës së shkelur ndaj shtetasit Sh. Ç.

Në përfundim, Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e parë vazhdimin e kësaj situatë, si shkak për cenimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit, në bazë të Nenit 63/3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstatojnë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...", si dhe në bazë të Nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme, për korrigjimin dhe anulimin e faturimit të padrejtë për muajin prill 2015, ardhur si pasojë e një gabimi në përllogaritje, ndaj shtetasit Sh. Ç.

Në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, lutemi të informohemi brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R E

Etilda GJONAJ (SALIU)